



---

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 3.5 pika (i), 15.1 pika (a), (d), 21.2, 44, 46, 47, 49, 55, 56 dhe 66 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Viti III, Nr. 28, datë 4 qershor 2008),

Duke marrë parasysh,

Obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në lidhje me Marrëveshjen Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (me tutje referuar si "Marrëveshja për HPEA") që nga hyrja e saj e përkohshme në fuqi për Kosovën më 10 tetor 2006,

Rregulloren e AAC-së Nr. 3/2009 të datës 30 tetor 2009, e cila zbaton në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës Rregulloren (EC) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 20 shkurt 2008 për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe për themelimin e Agjencisë Evropiane për Sigurinë në Aviacion,

Rregulloren e AAC-së Nr. 4/2009 të datës 30 tetor 2009, e cila zbaton në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës Rregulloren e Komisionit (EC) Nr. 1702/2003, të datës 24 shtator 2003, që përcakton rregullat implementuese për certifikimin e vlefshmërisë ajrore dhe certifikimin mjedisor të mjeteve ajrore dhe prodhimeve, pjesëve dhe pajisjeve të lidhura me to, si dhe për certifikimin e organizatave projektuese dhe prodhuese,

Me qëllim të implementimit të Rregullores së Komisionit (EU) Nr. 748/2012 të datës 3 gusht 2012, që përcakton rregullat implementuese për certifikimin e vlefshmërisë ajrore dhe certifikimin mjedisor të mjeteve ajrore dhe prodhimeve, pjesëve dhe pajisjeve të lidhura me to, si dhe për certifikimin e organizatave projektuese dhe prodhuese, e cila shfuqizon Rregulloren e Komisionit (EC) Nr. 1702/2003, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik me të gjitha palët e interesuara, në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

## **RREGULLORE Nr. 6/2015**

# **PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE IMPLEMENTUESE PËR CERTIFIKIMIN E VLEFSHMËRISË AJRORE DHE CERTIFIKIMIN MJEDISOR TË MJETEVE AJRORE DHE PRODHIMEVE, PJESËVE DHE PAJISJEVE TË LIDHURA ME TO, SI DHE PËR CERTIFIKIMIN E ORGANIZATAVE PROJEKTUESE DHE PRODHUESE**

### **Neni 1**

Kjo Rregullore përcakton, në përputhje me Nenin 5.5 dhe Nenin 6.3 të Aneksit të Rregullores së AAC-së Nr. 3/2009, kërkesat e përbashkëta teknike dhe procedurat administrative për certifikimin e prodhimeve, pjesëve dhe pajisjeve në lidhje me vlefshmërinë ajrore dhe mbrojtjen e mjedisit, duke specifikuar:

- a) lëshimin e certifikatave të tipit, certifikatave të kufizuara të tipit, certifikatave suplementare të tipit dhe ndryshimet e këtyre certifikatave;
- b) lëshimin e certifikatave të vlefshmërisë ajrore, certifikatave të kufizuara të vlefshmërisë ajrore, lejimit për fluturim dhe certifikatave për kthimin e autorizuar në përdorim;
- c) lëshimin e aprovimeve për projekte të riparimit;
- d) dëshminë e përputhjes me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit;
- e) lëshimin e certifikatave të zhurmës;
- f) identifikimin e prodhimeve, pjesëve dhe pajisjeve;
- g) certifikimin e pjesëve dhe pajisjeve të caktuara;
- h) certifikimin e organizatave projektuese dhe prodhuese;
- i) lëshimin e direktivave për vlefshmërinë ajrore.

### **Neni 2**

2.1 Rregullorja e Komisionit (EU) Nr. 748/2012, e datës 3 gusht 2012, që përcakton rregullat implementuese për certifikimin e vlefshmërisë ajrore dhe certifikimin mjedisor të mjeteve ajrore dhe prodhimeve, pjesëve dhe pajisjeve të lidhura me to, si dhe për certifikimin e organizatave projektuese dhe prodhuese, e ndryshuar me:

- Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 7/2013, të datës 8 janar 2013, e cila e ndryshon Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 748/2012 që përcakton rregullat implementuese për certifikimin e vlefshmërisë ajrore dhe certifikimin mjedisor të mjeteve ajrore dhe prodhimeve, pjesëve dhe pajisjeve të lidhura me to, si dhe për certifikimin e organizatave projektuese dhe prodhuese, dhe

- Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 69/2013, të datës 27 janar 2014, e cila e ndryshon Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 748/2012 që përcakton rregullat implementuese për certifikimin e vlefshmërisë ajrore dhe certifikimin mjedisor të mjeteve ajrore dhe prodhimeve, pjesëve dhe pajisjeve të lidhura me to, si dhe për certifikimin e organizatave projektuese dhe prodhuese,

më tutje e referuar si “Rregullorja e Komisionit”, shpallet e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Rregullorja e Komisionit i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje si shtojcë dhe formon pjesën e saj përbërëse.

2.2 Dispozitat e zbatueshme të Rregullores së Komisionit janë nenet 1-11 si dhe Shtojcat I-III, ashtu siç janë ndryshuar me rregulloret e përmendura në paragrafin 1.

2.3 Çdo dispozitë e amendamenteve të ardhshme të Rregullores së Komisionit, me futjen e saj në fuqi si pjesë e Shtojcës I ose II të Marrëveshjes për HPEA, do të jetë e zbatueshme drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës.

### **Neni 3**

3.1 Kuptimi i shprehjeve dhe definicioneve të përdorura në këtë Rregullore janë të përfshira në Nenin 1 të Rregullores së Komisionit.

3.2 Pavarësisht nga paragrafi mësipër, termet “Komuniteti”, “ligji i Komunitetit”, “legjislacioni i Komunitetit”, “Instrumentet e Komunitetit”, “Traktati i KE”, “aeropot i Komunitetit”, “Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane”, “Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian”, “transportues ajror i Komunitetit” dhe “Shtet(e) Anëtar(e)”, të cilat mund të referohen në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi në Rregulloren e Komisionit, duhet të lexohen në përputhje me Pikat 2 dhe 3 të Shtojcës II të Marrëveshjes për HPEA.

3.3 Për qëllim të kësaj Rregulloreje, shprehja “autoriteti kompetent”, siç është e referuar në Rregulloren e Komisionit, për organizata të cilat veprimtarinë kryesore të biznesit e kanë në Republikën e Kosovës, do të nënkuptojë Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës; ose “Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit” (më tutje e referuar si “Agjencia”) nëse kjo kërkohet nga Republika e Kosovës.

### **Neni 4**

4.1 Mënyrat e Pranueshme të Përshtatshmërisë (AMC) dhe Materialet Udhëzuese (GM) të përcaktuara me Vendimet e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Nr. Vendimi DE 2012/020/R i datës 30 tetor 2012; siç mund të ndryshohet, do të zbatohen.

4.2 Specifikacionet e Certifikimit (CS) të përcaktuara me Vendimet e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Vendimi DE 2003/013/RM i datës 14 nëntor 2003; Vendimi DE 2003/014/RM i datës 14 nëntor 2003; Vendimi DE 2003/002/RM i datës 17 tetor 2003,

Vendimi DE 2008/014/R i datës 18 dhjetor 2008, Vendimi DE 2012/001/R i datës 27 janar 2012; Vendimi DE 2003/015/RM i datës 14 nëntor 2003; Vendimi DE 2003/016/RM i datës 14 nëntor 2003; Vendimi DE 2011/012/R i datës 5 dhjetor 2011; Vendimi DE 2009/005/R i datës 26 shkurt 2009; Vendimi DE 2013/011/R i datës 1 korrik 2013; Vendimi DE 2003/003/RM i datës 17 tetor 2003; Vendimi DE 2003/004/RM i datës 17 tetor 2003; Vendimi DE 2003/005/RM i datës 17 tetor 2003; Vendimi DE 2003/009/RM i datës 24 tetor 2003; Vendimi DE 2003/010/RM i datës 24 tetor 2003; Vendimi DE 2011/005/R i datës 27 qershor 2011; Vendimi DE 2003/007/RM i datës 24 tetor 2003; Vendimi DE 2014/033/R i datës 2 dhjetor 2014; Vendimi DE 2003/018/RM i datës 14 nëntor 2003; Vendimi DE 2003/017/RM i datës 14 nëntor 2003; Vendimi DE 2014/004/R i datës 31 janar 2014; Vendimi DE 2014/005/R i datës 31 janar 2014; Vendimi DE 2014/006/R i datës 31 janar 2014; Vendimi DE 2014/008/R i datës 31 janar 2014, siç mund të ndryshohen, do të zbatohen.

4.3 Mënyrat e Pranueshme të Përshtatshmërisë (AMC), Materialet Udhëzuese (GM) dhe Specifikacionet e Certifikimit (CS) të referuara në paragrafët 4.1 dhe 4.2 janë të publikuara në faqen e internetit të Agjencisë.

#### **Neni 5**

Në rast të interpretimit të Rregullores së Komisionit do të përdoret versioni origjinal në gjuhën angleze siç është i publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

#### **Neni 6**

Kjo Rregullore shfuqizon Rregulloren e AAC-së Nr. 4/2009 e cila përcakton rregullat zbatuese për vlefshmërinë ajrore dhe certifikimin mjedisor të avionëve dhe prodhimeve, pjesëve dhe pajisjeve të ngjashme, si dhe për certifikimin e organizatave të dizajnit dhe prodhimit, të datës 30 tetor 2009.

#### **Neni 7**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më pesëmbëdhjetë (15) ditë pas nënshkrimit.

Prishtinë, 8 korrik 2015

**Dritan Gjonbalaj**  
Drejtori i Përgjithshëm